



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 21 / Prot. 10

Tiranë, më 14.09.2021

V E N D I M

Nr. 51, datë, 14. 09. 2021

PËR DHËNIE MASE DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim të oficerit të policisë gjyqësore Fatos Sulo, dëgjoji pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Mbi kërkesën e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, datë 17.05.2021, plotësuar me kërkesën datë 16.06.2021, "Për proçedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Fatos Sulo, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore me Nr.21/4prot., datë 21.06.2021, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", ka nxjerrë Urdhërin nr.31, datë 25.06.2021 "Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Fatos Sulo", për kryerjen e shkeljeve disiplinore, të parashikuara nga neni 33/4, gërma "ç" e ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit Andi Pogaçe dhe Relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të ligjit procedural penal nga ana e oficerit të policisë gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Fatos Sulo, gjatë hetimit të procedimit penal nr.1420, regjistruar në datën 09.12.2020, në ngarkim të shtetasit Olson Sulejmani, për veprën penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" (në gjendje të dehur), parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Nga aktet që u administruan gjatë seancës dëgjimore për proçedimin disiplinor, rezulton se:

2.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në datën 09.12.2020 ka regjistruar procedimin penal Nr. 1420, të vitit 2020 për veprën penale “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*” (në gjendje të dehur), të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Olson Sulejmani. Për hetimin e këtij procedimi penal është ngarkuar oficeri i Policisë Gjyqësore i Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendoer të Policisë Fier, Fatos Sulo, i cili ka referuar edhe materialin kallëzues në prokurori.

2.2 Nga aktet e procedimit penal rezulton se në datën 05.12.2020, shtetasi Olson Sulejmani duke drejtuar motomjetin e tij, të markës “Mercedes Benz”, në rrugën Dukas – Patos, ka humbur kontrollin e mjetit dhe ka dalë nga rruga. Për shkak të dëmtimeve të marra, drejtuesi i mjetit është transportuar në Spitalin Rajonal të Fierit për ti dhënë ndihmë mjekësore.

Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Fatos Sulo, pasi janë kryer veprimet e para hetimore, në datën 09.12.2020, materialet janë referuar për vlerësim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

Sipas informacionit për referimin e veprës penale, të oficerit të Policisë Gjyqësore Fatos Sulo, gjendja shëndetësore e drejtuesit të mjetit Olson Sulejmani nuk lejonte kryerjen e testit për kryerjen e verifikimit paraprak të nivelit të alkolit. Për këtë arsye, në datën 05.12.2020, ora 16.00, drejtuesit të mjetit i është marrë mostra e gjakut me qëllim kryerjen e ekspertimit toksikologjik. Mostra e gjakut është dërguar për ekspertim në Insitutin e Mjekësisë Ligjore, në datën 10.12.2020, me shkresën e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, nr.10544, datë 09.12.2020.

2.3 Në vijim të hetimeve, nga ana e prokurorisë, është administruar Akti Ekspertimit Toksikologjik, nr.04, datë 30.12.2020, i Institutit të Mjekësisë Ligjore. Në aktin e ekspertimit toksikologjik, eksperti ka konkluduar se “*Nga shqyrtimi i rastit konstatohet se mostra e gjakut të shtetasit Olson Sulejmani është sjellë me vonesë, jashtë intervalit 48 orësh nga momenti i marrjes.... Mostra biologjike të cilat dërgohen në laboratorin e Toksikologjisë jashtë intervalit kohor prej 48 orësh, nuk merret në konsideratë për tu analizuar sepse: Mostra biologjike duhet të mbahet në kushte frigoriferike në temperaturë +4 gradë celsius deri në 48 orë dhe menjëherë të dërgohen në Laborator për të filluar proceset e analizës toksikologjike. Mbajtja e mostrave biologjike nën ndikimin e temperaturave të larta, të dritës, etj, bën që këto mostra si rezultat i metaboliteve të jenë të pabesueshëm në rezultatin e marrë. Nisur nga fakti që mostra biologjike e shtetasit Olson Sulejmani nuk është dorëzuar në laborator sipas procedurave standarte të punës dhe dorëzimit korrekt nuk mund të analizohet pasi cilido qoftë rezultati i marrë (pozitiv apo negativ), nuk mund të merret në konsideratë për interpretim. Rezultati i marrë është i pabesueshëm në rastin konkret nga pikpamja toksikologjike – ligjore.*”

2.4 Ndodhur para kësaj rrethane, Prokurori i çështjes ka urdhëruar kryerjen e një ekspertimi të dytë toksikologjik, mbi bazën e të dhënave të pasqyruara në kartelën mjekësore të shtetasit Olton Sulejmani.

Edhe në aktekspertimin e dytë, nr.907, datë 07.05.2021 të Institutit të Mjekësisë Ligjore është dhënë konkluzioni se “*Nga përshkrimet e fletë – daljes nga spitali i Fierit, si edhe të dhënat e ofruara nga kartela klinike e SUT Tiranë nuk mund të konkludohet nëse ky shtetas ka përdorur apo jo alkool etilik.*”

2.5. Në rrethanat e mësipërme, Prokurori i çështjes, Andi Pogaçe, ka aritur në konkluzionin se nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Fatos Sulo janë kryer disa shkelje flagrante ligjore gjatë hetimit të procedimit penal nr.1420 të vitit 2020. Prokurori Andi Pogaçe parashtron në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor se, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Fatos Sulo është vepruar në kundërshtim me procedurat standarte të punës që përdor Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe të cilat ia ka dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Fier me shkresën nr.1340 prot., datë 03.09.2015, sipas së cilës, mostra biologjike duhet të depozitohet pranë IML Tiranë, brenda 48 orëve. Në rastin konkret mostra biologjike nga oficeri Fatos Sulo është dërguar në IML pas 5 ditëve. Si pasojë e kësaj shkelje, me pasoja shumë të rënda, organi i prokurorisë i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për pushimin e çështjes penale.

Këto veprime dhe shkelje të kërkesave ligjore dhe proceduriale, të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore Fatos Sulo, nga ana e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, konsiderohen si shkelje disiplinore të parashikuara nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 4, gërma “ç”. Në kushtet kur oficeri i Policisë Gjyqësore Fatos Sulo kishte dijeni direkte se nuk ishte kryer verifikimi paraprak me aparatën “Drager” dhe mostra biologjike ishte e vetmja provë për evidentimin e faktit nëse i dyshuari kishte konsumuar pije alkolike, apo ishte nën efektin e lëndëve narkotike, e bën sjelljen e tij dhe shkeljen disiplinore të rëndë, ndaj kërkon dhënien ndaj tij të masave disiplinore, të parashikuara nga neni 34, pika 4 e ligjit të sipërcituar.

3. Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor, analiza e tyre, shjegimet e vetë subjektit të procedimit disiplinor, u provua se gjatë hetimit të procedimit penal nr.1420, të vitit 2020, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Fatos Sulo, janë shkelur kërkesat e Kodit të Procedurës Penale dhe aktet e tjera të dala në zbatim të tij, cilat parashikojnë rregullat për kryerjen e ekspertimit si mjet për kërkimin e provës dhe dispozitat që parashikojnë mënyrën e marrjes, fiksimit, administrimit, dhe trajtimin e provave, përfshirë dhe materialet biologjike. U provua se mostra e gjakut për ekspertim është marrë nga i dyshuari në datën **05.12.2020** dhe është dorëzuar në Institutin e Mjekësisë Ligjore për kryerjen e ekspertimit toksikologjik, në datën **10.12.2020**, tej afatit 48 orë, të përcaktuar në procedurat standarte të këtij instituti. Instituti i Mjekësisë Ligjore, si institucioni përgjegjës dhe kompetent për kryerjen e ekspertimeve mjekoligjore, për kryerjen e ekspertimeve toksikologjike me mostrat e gjakut, ka përcaktuar si kohë të dorëzimit të mostrave të gjakut në këtë institut afatin 48 orë nga momenti i marrjes së saj nga subjekti që kërkon kryerjen e ekspertimit. Instituti i Mjekësisë Ligjore argumenton se dërgimi i mostrave të gjakut tej këtij afati, dhe jo në kushtet e kërkuara për ruajtje, bën që mostra e gjakut të humbasë cilësitë si rezultat i metabolizmave dhe rezultati i marrë nga analizat të jetë i pabesueshëm.

Nga përmbajtja e shkresës (qarkore) të Institutit të Mjekësisë Ligjore nr.1340.prot., datë 03.09.2015, dërguar të gjitha institucioneve me të cilat ky institut punon, rezulton se gjithë oficerët e Policisë Gjyqësore të drejtorive të policisë në qarqe dhe në komisariate janë njohur me procedurat standarte që duhet të ndjekin për marrjen, ruajtjen dhe afatin e dorëzimit të mostarve të gjakut pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Në kundërshtim me këto parashikime dhe standarte, mostra e gjakut për ekspertim, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Fatos Sulo është dorëzuar në Institutin e Mjekësisë Ligjore, tej afatit 48 orë, në datën 10.12.2020, pas pesë ditëve.

Këto veprime dhe mosveprime të oficerit të Policisë Gjyqësore, Fatos Sulo janë në shkelje të kërkesave të neneve 30, 293, 294 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat rregullojnë mënyrën

e marrjes, fiksimit, administrimit, dhe trajtimit të provave, dhe nenit 178 e vijues të këtij Kodi, për kryerjen e ekspertimeve, duke sjellë pasoja të pariparueshme për hetimin e procedimit penal.

Në kushtet kur nuk ishte kryer verifikimi paraprak me aparatën "Drager", për përdorimin e alkolit nga drejtuesi i mjetit, mostra biologjike e gjakut ishte e vetmja prove për të evidentuar nëse i dyshuari kishte konsumuar pije alkolike apo ishte nën efektin e pijes alkolike apo lëndëve narkotike në momentin e aksidentit. Mbajtja e mostrës dhe dorëzimi i saj në IML nga oficeri i Policisë Gjyqësore Fatos Sulo tej afatit 48 orë, për shkak të ndryshimeve që pëson, e ka bërë të pamundur nxjerjen e një konkluzioni kategorik për të përcaktuar gjendjen e drejtuesit të mjetit në momentin e aksidentit, nëse ka qenë nën ndikimin e efektit të pijeve alkolike apo lëndëve narkotike. Moskryerja e ekspertimit toksikologjik, si i vetmi veprim dhe provë për zgjidhjen e çështjes, për shkak të vonesave në dorëzimin e mostrës së gjakut në IML nga oficeri i Policisë Gjyqësore Fatos Sulo, në mungesë dhe të verifikimit paraprak me aparatën "Drager", ka detyruar prokurorin e çështjes të kërkojë pushimin e çështjes në gjykatë.

4. Komisioni i Policisë Gjyqësore, duke ju referuar parashikimeve që ligji nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", neni 33, bën për shkeljet disiplinore, veprimet dhe sjelljet që konsiderohen shkelje disiplinore, natyrën e tyre dhe pasojat që duhet të sjellin, vlerëson se, shkelja e kërkesave të Kodit të Procedurës Penale dhe akteve të tjera të dala në zbatim të tij, cilat parashikojnë rregullat për kryerjen e ekspertimit si mjet për kërkimin e provës dhe dispozitat që parashikojnë mënyrën e marrjes, fiksimit, administrimit, dhe trajtimit të provave, përfshirë dhe materialet biologjike, të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Fatos Sulo, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që kanë sjellë, përbëjnë shkelje disiplinore, në formën, ***"kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Procedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes"***, të parashikuar nga neni 33, pika 4 gërma "ç" i ligjit 25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

Shkelja e kryer nga oficeri i Policisë Gjyqësore konsiderohet shumë e rëndë në kuptim të pikës 4, gërma "ç" të nenit 33 të ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" për arsye se:

Së pari. Oficeri i Policisë Gjyqësore ka kryer shkelje flagrante të dispozitave ligjore dhe nënligjore që trajtojnë dhe rregullojnë mënyrën e fiksimit, administrimit dhe trajtimit të materialeve biologjike sipas procedurave standarte të punës të Institutit të Mjekësisë Ligjore, pasi megjithëse ka marrë kampionin e gjakut si burim prove, nëpërmjet veprimeve pasive dhe neglizhente, duke e mbajtur atë pa dorëzuar në IML tej afatit të përcaktuar, ka bërë që të humbasë vlera e kësaj prove.

Së dyti. Nga shkeljet e kryera nga Oficeri i Policisë Gjyqësore Fatos Sulo kanë ardhur pasoja të pariparueshme për hetimin dhe ecurinë e procedimit penal. Si rezultat i shkeljeve të kryera, nuk ka qenë e mundur evidentimi i faktit nëse personi ndaj të cilit kishin filluar hetimet, Olson Sulejmani, ka qenë në gjendje të dehur, apo nën efektin e lëndëve narkotike në momentin e aksidentit. Mungesa e një rezultati dhe konkluzioni kategorik nga ekspertët e IML, dhe pamundësia e tyre për ta dhënë atë, për shkak të dorëzimit të mostrës së gjakut me vonesë nga Oficeri i Policisë Gjyqësore Fatos Sulo, ka vendosur prokurorin para detyrimit për të kërkuar pushimin e çështjes.

4.1 Lidhur me këto shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Fatos Sulo shpjegoi se, nuk i pranonte, se vonesat në dorëzimin e mostrës së gjakut ka ardhur sepse kanë qenë ditët e pushimit javor dhe se IML nuk ka punonjës të angazhuar në këto ditë. Gjithashtu pretendoi se në bërjen e kërkesës Prokurori Andi Pogaçe niset nga mosmarveshjet personale që ka me këtë oficer të Policisë Gjyqësore, për shkak të mosgjatësisë së një fashikulli procedimi penal.

Shpjegimet dhe pretendimet e oficerit të policisë gjyqësore Fatos Sulo, nuk justifikojnë shkeljet e kryera dhe vonesën në dorëzimin e mostrës biologjike në IML. Shpjegimi se shkak i vonesës ka qenë fakti se ka qenë fundjavë, nuk mund të justifikojnë zvaritjen dhe vonesën prej 5 ditësh për dorëzimin e mostrës në IML. Referuar, ligjit nr.25/2019 “Për funksionimin dhe organizimin e Policisë Gjyqësore”, nenet 2, pika 6 dhe neni 4, gërma “b”, oficerët e policisë gjyqësore të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit, të ngarkuar posaçërisht me kryerjen e hetimeve, kanë detyrimin ligjor për marrjen e masave për respektimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit që rregullojnë dhe dispijlojnë oficerët e policisë gjyqësore për hetimin e veprave penale.

5. Duke e konsideruar të provuar shkeljen disiplinore të kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Fatos Sulo, Komisioni, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33, i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta;
- b) Të rënda;
- c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në gërmën “ç” pika 4 e nenit 33 të ligjit, parashikon si **shkelje shumë të rëndë** “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasojë për hetimin e çështjes”.

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Fatos Sulo, Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljeve disiplinore të kryera prej tij, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit lidhur me ngarkesën në punë dhe personalitetin e tij. Komisioni merr parasysh faktin që, gjatë vitit 2020 oficeri Fatos Sulo ka përballuar një volum të konsiderueshëm pune.

Gjithashtu Komisioni i referohet parashikimeve të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer.

Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas rradhës, a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje me paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në një vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.

Në pikën 4 të nenit 34 parashikohet që për shkeljet shumë të rënda jepen masat disiplinore “pezullim nga detyra deri në 6 muaj” ose “largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të”.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon që ndaj oficerit të policisë gjyqësore Fatos Sulo të japë masën disiplinore **“pezullim nga detyra për 6 muaj”**, parashikuar nga neni 34, pika 1, gërma “ç” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10 shkronja “ç”, 11 pika 4, neni 33 pika 4, gërma “ç”, neni 34, pika 1, gërma “ç”, pika 4 dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore, me 4 vota pro,

V E N D O S I:

1. Oficerit të policisë gjyqësore **Fatos Sulo** , me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, i jepet masa disiplinore **“Pezullim nga detyra për gjashtë muaj”**.
Për peridhën gjashtë mujore të pezullimit, i ndalohet të ushtrojë atributet dhe funksionet e oficerit të Policisë Gjyqësore.
2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Fatos Sulo , i cili, në bazë të neni 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Fier .
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Fatos Sulo.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI

ANËTAR

ARJAN MUÇA

ANËTAR

HARI GOGO

ANËTAR

ODISE MOÇKA

ANËTAR

ALBERT MUÇO